



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 shkurt 2024
Nr. ref.: RK 2314/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI134/22

Parashtrues

“AFA Energy sh.p.k”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimit [ARJ nr. 22/2022]
të Gjykatës Supreme të Kosovës të 15 prillit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania „AFA Energy sh.p.k.” nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqëson shoqëria e avokatëve “RPHS Law” SH.P.K. me seli në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston aktgjykimin [ARJ nr. 22/2022] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 15 prillit 2022, në lidhje me aktvendimin [AA. nr. 79/2022] e Gjykatës së Apelit të Kosovës të 14 shkurtit 2022 dhe aktvendimin [A. nr. 2701/2021] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 29 dhjetorit 2021.
3. Aktgjykimi i kontestuar [ARJ nr. 22/2022] i Gjykatës Supreme të Kosovës i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 22 qershor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 8 shtator 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 14 shtator 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KI134/22] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
9. Më 16 shtator 2022, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi atij të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës Supreme si dhe Zyres së Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE).

10. Më 29 shtator 2022, ZRRE-ja dorëzoi komentet e saj në lidhje me kërkesën e parashtruesit, mirëpo, duke parë thelbin e tyre, Gjykata konstaton se këto komente kanë të bëjnë me kontestin administrativ që parashtruesi i kërkesës po e zhvillon pranë gjykatave të rregullta lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, dhe që këtu nuk është rasti, dhe rrjedhimisht Gjykata as nuk do t'i përmend ato në këtë raport.
11. Më 4 tetor 2022, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës i dërgoi Gjykatës autorizimin për përfaqësim.
12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 7 qershor 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe vendosi që vendimmarrja për raportin të shtyhet për njërin nga seancat e radhës.
14. Më 18 janar 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës është kompani që merret me prodhimin dhe distribuimin e energjisë elektrike nga kapacitetet e veta, përkatësisht dy hidrocentrale që janë ndërtuar përgjatë rrjedhës së lumit në zonën e komunës së Kaçanikut dhe Hanit të Elezit. Me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese, "HC Kotlina 1 dhe, HC Kotlina 2", parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në ZRRE më 12 qershor 2015, përmes së cilës ka kërkuar marrjen e autorizimeve të nevojshme. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 25 shtator 2015 nxori Vendimin për pëlqimin mjedisor për ndërtimin e hidrocentraleve. ZRRE më 28 janar 2016, gjithashtu nxori aktvendimin e parë, për miratimin e përkohshëm, dhe më pas më 29 mars 2018 nxori aktvendimin me të cilin i lëshoi miratimin përfundimtar parashtruesit të kërkesës, me kushte të përcaktuara qartë që ai duhet t'i plotësojë. Siç thuhet në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës dy herë kërkoi nga ZRRE-ja që të shtyjë afatin për zbatimin e projektit. Kërkesa e parë për shtyrje të afatit është dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës më 24 janar 2017, të cilën ZRRE-ja e ka pranuar dhe i ka dhënë parashtruesit të kërkesës një afat të ri për zbatimin e projektit. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e dytë për zgjatjen e afatit për zbatimin e projektit në ZRRE më 15 mars 2021, mirëpo, më 7 tetor 2021, ZRRE-ja lëshoi vendimin për atë kërkesë [ZRRE: V_1420_2021], duke refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa anuloi miratimin përfundimtar për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
16. Në vendimin [ZRRE: V_1420_2021] për anulimin a aktvendimit përfundimtar ZRRE-ja theksoi:

“ZRRE me datë 17.09.2021, kanë realizuar vizitën monitoruese në terren, në vend-punishite, në lokacionin ZK Kotlinë, komuna e Hanit të Elezit për të parë nga afër punimet sipas planit dinamik të realizimit të prezantuar nga vet aplikuesi, brenda periudhës së autorizimit finat dhe për të vërtetuar arsyeshmërinë e kërkesës për shtyrje. Pas vlerësimit të situatës në vend punishite ishte vërtetuar se aplikuesi nuk ka realizuar punimet sipas planit dinamik të prezantuar nga ana e tij,

pasi që gjendja në terren është fillestare, përkundër afatit prej më shumë se tre (3) vite, nga koha e lëshimit të Autorizimit.

Shoqëria "AFA Energy" SH.P.K., ka të drejt të ri-aplikoj për marrje të Autorizimit pas plotësimit të kushteve[...]."

17. Duke pasur parasysh se ZRRE-ja me vendimin [ZRRE: V_1420_2021] ka revokuar miratimin përfundimtar për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, përmes së cilës kërkoi, **i**) shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [ZRRE: V_1420_2021], të 7 tetorit 2021, dhe, **ii**) vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit [ZRRE: V_1420_2021], në një kontest administrativ.
18. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata vlerësimin e vendimeve të gjykatave që janë marrë në lidhje me kërkesëpadinë për **i**) shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [ZRRE: V_1420_2021], të 7 tetorit 2021, dhe rrjedhimisht Gjykata do të paraqesë më poshtë faktet vetëm në lidhje me këtë procedurë.

i) Procedurat gjyqësore lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së [ZRRE: V_1420_2021], të 7 tetorit 2021

19. Më 29 dhjetor 2021, Gjykata Themelore nxori aktvendimin [A. nr. 2701/2021], me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës ka kërkuar nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [RUE: V_1420_2021], të 7 tetorit 2021, derisa gjykata të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë.
20. Në arsyetimin e aktvendimit [A. nr. 2701/2021], Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi:

"Për të vlerësuar kërkesën e paditësit, Gjykata i'u referua nenit 22 par. 2, të Ligjit për Konfliktet Administrative, ku përcaktohet se "Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund t'a shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar".

Po ashtu gjykata i'u referua nenit 22.6 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se "Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata, shtyrjen e aktit administrativ, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas paragrafit 2 të këtij neni".

Gjykata duke vlerësuar kërkesën e paditësit, vëren se i njëjti nuk e ka bërë të besueshëm pretendimin e tij me provat të cilat ia ka bashkangjitur padisë, dhe me parashtruesin e dt. 24.11.2021, se me ekzekutimin e vendimit të kontestuar i njëjti do t'i sillte dëm, i cili vështirë do të riparohej dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, dhe as që shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kushte këto ligjore të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative nga paditësi, për të shtyrë pastaj gjykata ekzekutimin e vendimit të kontestuar".

21. Parashtruesi i kërkesës parashtrori ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit [A. nr. 2701/2021], të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 14 shkurt 2022, Gjykata e Apelit nxori aktvendimin [AA nr. 79/2022], përmes të cilit është refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës si e pabazuar, duke vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në tërësi.
23. Në arsyetimin e aktgjykimit [AA. nr. 79/2022], Gjykata e Apelit, ndër të tjera, theksoi:

“Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par. 2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të behet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t’j sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi me ankesën e ushtruar kërkon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës V _1420 2021 i dt. 07.10.2021, me pretendim se me ekzekutimin e vendimit të kontestuar propozuesit, do t’i sillte dëm të konsiderueshëm dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik e as nuk i shkakton dëm palës kundërshtare dhe personave të interesuar.

Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të propozuesit- paditësit, në ankesë, të cekura më lartë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të aktvendimit të ankimuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par. 2 dhe 6 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar”.

24. Parashtruesi i kërkesës parashtrori kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar “shkelje të dispozitave procedurale, zbatim të gabuar të së drejtës materiale”.
25. Më 15 prill 2022, Gjykata Supreme nxori aktgjykimin [ARJ. nr. 22/2022], përmes të cilit refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër aktvendimit [AA. nr. 79/2022] të Gjykatës së Apelit.
26. Në arsyetimin e aktgjykimit [ARJ. nr. 22/2022], Gjykata Supreme ndër të tjera deklaroi:

“Kolegji i Gjykatës Supreme duke pasur parasysh që në këtë çështje kontestohet Vendimi me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për tu shtyrë vendimi j më par më për autorizimin final por në të njëjtën kohë me të njëjtin vendim përfundon afati i vlefshmërisë së vendimit të njëjtë nr. V-024_2018 të dt. 29.03.2018, në këtë çështje po të lejohej shtyrja deri në vendosjen meritore si kërkon pala paditëse, ashtu që paditësi me aktivitetin e tij sipas lejes – Vendimit për autorizimin final të më par më, dhe nëse në fund të procesit gjyqësor do të rezultonte se vendimi i atakuar me padi është ligjor dhe i drejtë, dëmi do të ishte e dhe më i madh edhe për palën paditëse. Prandaj, duke patur para sysh çështjen e vendosur nga e paditura me vendimin e saj të atakuar me padi, me përfundimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit të tij, nuk provohet se me këtë mënyrë të vendosjes paditësit i shkaktohet dëm i pa riparueshëm apo vështirë i pa riparueshëm gjer në vendosjen meritore sipas padisë, sepse si do që të vendoset çështja kryesore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë se vendimit të organit të paditur me vendim përfundimtar gjyqësor, apo nëse do të vërtetohej se vendimi i të paditurit është jo ligjor dhe çështja do të vendosej në dobi të palës paditëse, ekzistojnë mekanizmat dhe mënyra e kompensimit të dëmeve eventuale me mjete monetare, prandaj dëmi do të ishte i sanueshëm.

Theksimet në kërkesë se me shtyrjes e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur nuk dëmtohet interesi publik por përkundrazi do ti shërbente interesit publik, sepse me ndërtimin e hidrocentralit, Kotlina do të shtohet edhe një burim shtesë i energjisë që do të ndikonte në ekonominë e vendit me punësimin e punëtorëve etj., po ashtu nuk janë të qëndrueshme, relevante apo me ndikim për tu pranuar në këtë fazë të procedurës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, para se të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me padi, në procedurë të rregullt nga gjykata.

Pjesa tjetër e theksimeve në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, që kanë të bëjnë lidhur me ligjshmërinë e vendimit të organit të paditur dhe procedurat e zbatuara gjatë nxjerrjes së tij nga organi i paditur të cekura si në kërkesë, në këtë fazë të procedurës, përkatësisht vendosjes për masë të përkohshme nga gjykata nuk shqyrtohen, sepse do të prejudiohej vendosja meritore e çështjes kryesore lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur të atakuar me padi”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës thekson se përmes vendimeve të gjykatave të rregullta në procedurën sipas kërkesës në lidhje me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [ZRRE: V_1420_2021], janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës si dhe nenin 6 të KEDNJ.
28. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës në vijim të kërkesës ka dhënë shpjegim vetëm për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, ai nuk jep arsyetim specifik për to në kërkesë.
29. Në mbështetje të pretendimit për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës në radhë të parë thekson, **i**) vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe, **ii**) mungesën e

arsyetimit të vendimeve të Gjykatës Themelore, të Apelit dhe Gjykatës Supreme në lidhje me kërkesën e tij.

i) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale

30. Në mbështetje të shkeljeve të përmendura, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykata e Apelit e Kosovës dhe Gjykata Themelore në Prishtinë, përkundë që kanë refuzuar parashtruesin e kërkesës, ankesat dhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit V_1420 2021, nuk kanë dhënë asnjë arsyetim lidhur me shkaqet e refuzimit, veprimet e tilla konsistojnë në shkelje të Neneve 31 dhe 24 të Kushtetutës së Kosovës“*. Gjithashtu *„deri tek shkeljet e dispozitave të lartcekura kushtetuese gjykatat kanë ardhur si pasojë e mos-zbatimit të obligimeve të tyre ligjore, përkatësisht si pasojë e shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, që ka ndikuar që gjykatat të vërtetojnë në mënyrë të gabuar gjendjen faktike dhe të zbatojnë në mënyrë të gabuar të drejtën materiale”*.
31. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur kanë refuzuar kërkesën dhe ankesat e tij. Kjo ka ndodhur për arsye se, siç thekson parashtruesi i kërkesës, se përkundër faktit se janë plotësuar kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit [V_1420_2021], gjykatat nuk e kanë lejuar një gjë të tillë. Pikërisht qëllimi i parashtruesit të kërkesës, siç pretendon ai, ka qenë të dëshmojë me këtë kërkesë se gjykatat e kanë refuzuar gabimisht kërkesën (dhe ankesat e tij), pasi në këtë rast janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore nga neni 22 i KP, në mënyrë që kërkesa e tij të aprovohet.
32. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se shkeljet e lartpërmendura kanë ndodhur në të gjitha shkallët e gjykatave që kanë vendosur për kërkesën në fjalë, më konkretisht se Gjykata Themelore ka bërë shkelje bazuar në faktin se *“aktvendimi i Gjykatës Themelore është bazuar vetëm në disa fjali në të cilat i është referuar nenit 22, par. 2 dhe 6 të LKA-së; dhe se paditësi (parashtruesi i kërkesës) nuk e ka bërë të besueshëm pretendimin e tij me provat që ia ka bashkangjitur padisë në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore nga neni 22 i LKA-së”*, se Gjykata e Apelit nuk është marrë realisht me pretendimet e paditësit lidhur me shkeljen e neneve 160 dhe 8 të LPK nga Gjykata Themelore, por është nxjerrë vetëm në shqyrtimin meritore të kërkesës së tij – për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit V_1420_2020 sikur të gjykojë në shkallë të parë.

ii) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me mungesën e arsyetimit të vendimeve të gjykatave të rregullta

33. Në mbështetje të mosarsyetimit të vendimeve të gjykatave të rregullta, parashtruesi i kërkesës pretendon, *„Me rastin e vendimmarrjes, gjykatat obligohen që, në arsyetim të vendimeve të tyre, të tregojnë se cilat prova i kanë vlerësuar me rastin e vendosjes për atë rast. Një obligim i tillë parashihet në paragrafin 4 të Nenit 160 të LKA-së [...]”*.
34. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *„Gjykatat e tri shkallëve kanë marrë vendime që nuk përmbajnë arsyetim për provat që janë administruar me rastin e vendimmarrjes dhe as për faktet vendimtare për rastin”*.
35. Sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore ka kryer shkeljen e lartcekur ashtu që në aktvendimin [A. nr. 2701/2021] i është referuar nenit 22, paragrafët

2 dhe 6 të LKA-së, “dhe se me këtë rast nuk ka dhënë arsyetim për provat e tij të paraqitura, me të cilat vendimi është marrë në kundërshtim me nenin 160 paragrafi 4 i LPK-së.”.

36. Sa i përket shkeljes në Gjykatën e Apelit në kontekst të vendimit të paarsyetuar, parashtruesi i kërkesës e sheh këtë shkelje në faktin se Gjykata e Apelit nuk është marrë realisht me pretendimet e tij në lidhje me shkeljen e nenit 160 të LPK-së nga Gjykata Themelore, por ka marrë vendim që i është përgjigjur pjesërisht pretendimit lidhur me kërkesën për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, por në të njëjtën kohë duke mos i vlerësuar provat që ka paraqitur në mbështetje të këtyre pretendimeve.
37. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu e konstaton shkeljen e përmendur në kontekst të një vendimi të paarsyetuar edhe në Gjykatën Supreme, duke e vënë në lidhje me faktin se ajo nxori një vendim që vërteton vendimet e mëparshme, duke konstatuar se ato kanë qenë të bazuara në ligj dhe se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 22, paragrafët 2 dhe 6 të LKA-së, duke mos i arsyetuar ato, duke arsyetuar vetëm vlerësimin e kushteve të përmendura.

Pretendimet dhe komentet tjera të parashtruesit të kërkesës

38. Përveç pretendimeve të lartpërmendura, parashtruesi i kërkesës konsideron se si rrjedhojë e mos-shtyrjes së ekzekutimit të vendimit përkatës të ZRRE-së, “atij do t’i shkaktohet dëm material për shkak të humbjes së gjithë investimit të, dhe kjo do të ketë për pasojë largimin e investitorëve të huaj nga tregu i Kosovës dhe përfundimin e operimit të aktiviteteve biznesore [...]”.
39. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të Vendimit [V_1420 2021] jo vetëm që nuk është në kundërshtim me interesin publik, por i shërben të njëjtit, në mënyrë që Hidrocentrali i Kotlinës të ndikojë në çmimin e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit, të krijojë stabilitet ekonomik dhe do ta rriste konkurrencën në treg.
40. Parashtruesi i kërkesës rikujton se Gjykata Kushtetuese në vendimet [KI145/18](#), dhe [KI 75 / 21](#) ka paraqitur qëndrimin e saj, duke gjetur shkelje.
41. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën që ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme, të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, që vendimet e gjykatave të rregullta të shpallen të pavlefshme dhe ta kthejë procedurën në rigjykim.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato”.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]“

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”

Ligji nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative

Neni 22

[...]

“2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që

shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

[...]

6. Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni”.

Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 160

“160.4 Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato “.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

42. Gjkata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
43. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë

Neni 21

[...]

Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

Neni 113

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

44. Gjkata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me nenet 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

45. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të dorëzojë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës [KI41/09](#), parashtrues [Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.](#), Aktvendim për Papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe [KI35/18](#), parashtrues [“Bayerische Versicherungsverband”](#), Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).
46. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të tjera të paranueshmërisë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; se ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; se ka qartësuar aktin e autoritetit publik kushtetutshëmërinë e të cilit e konteston, konkretisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ nr. 22/2022] të 15 prillit 2022; i ka specifikuar të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar; si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenet 47 dhe 48 të Ligjit.
47. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka iniciuar dy procedura gjyqësore, njëra prej të cilave ka të bëjë me i) shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [ZRRE: V_1420_2021], të 7 tetorit 2021, dhe ii) kontestin administrativ lidhur me vlerësimin. e ligjshmërisë së vendimit [ZRRE: V_1420_2021] të ZRRE-së.
48. Procedura e cila gjendet në shqyrtim pranë kësaj gjykate ka të bëjë ekskluzivisht me i) shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [ZRRE: V_1420_2021], të 7 tetorit 2021, i cili është vendosur nga gjykatat e rregullta, dhe rrjedhimisht Gjykata në vazhdim në vazhdim të aktvendimit do të merret ekskluzivisht me këtë procedurë të parashtruesit të kërkesës dhe në kuadër të saj do të shqyrtojë bazueshmërinë e shkeljeve të pretenduara të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
49. Prandaj, Gjykata nuk do t'i marrë parasysh procedurat e zhvilluara para organeve kompetente të ZRRE-së dhe as nuk do të lëshohet në vlerësimin e pjesës së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me ii) kontestin administrativ, për arsye se ato do të

jenë objekt i kontrollit dhe vlerësimit gjyqësor sipas kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës.

i) Procedura gjyqësore lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [ZRRE: V_1420_2021], të 7 tetorit 2021

50. Përkitazi me thelbin dhe kontekstin e rrethanave të rastit konkret, duke marrë parasysh që vendimet e kontestuara ndërlidhen me vendime përkitazi me masa të sigurisë, përkatësisht “*procedura paraprake*”, Gjykata bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), duhet të vlerësojë aplikueshmërinë e garancive të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet pikës (b) të paragrafit (3) të rregullit 34 të Rregullores së punës, sipas së cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
51. Prandaj, vlerësimi i këtij kriteri në rrethanat e rastit, është i rëndësishëm sepse procedurat e zhvilluara pranë gjykatave të rregullta hyjnë në fushëveprimin e “*procedurave paraprake*”, përkatësisht Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ndërlidhet me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së, ndërsa kërkesëpadija për anulimin e vendimit të ZRRE-së është akoma në procedurën e shqyrtimit në merita. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë nëse neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i zbatueshëm në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës.

Aplikueshmëria e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në procedurën paraprake

52. Në këtë kontekst specifik, Gjykata vëren se çështja e aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në procedura paraprake është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta e Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
53. Gjykata rikujton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e neneve 24. [Barazia para ligjit], dhe 31. [E drejta në gjykim të drejtë] të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të KEDNJ, kanë të bëjnë kryesisht me procedurën paraprake në të cilën gjykatat vendosën lidhur me shtyrjen e përmbarimit të vendimit të ZRRE-së.
54. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata thekson se kriteret në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me procedurat e mëparshme janë përcaktuar gjithashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por pa u kufizuar në rastet [KI122/17](#), parashtrues *Česká Exportní Banka A.S.*, aktgjykim i 30 prillit 2018; [KI150/16](#), parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, aktgjykim i 31 dhjetorit 2018; [KI81/19](#), parashtrues *Skender Podrimqaku*, aktvendim për papranueshmëri i 9 nëntorit 2019; [KI107/19](#), parashtrues *Gafurr Bytyqi*, aktvendim për papranueshmëri i 11 marsit 2020; [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, aktgjykim i 29 marsit 2021. Parimet e përgjithshme të vendosura me vendimet e sipërpërmendura të Gjykatës bazohen në rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, aktgjykim i 15 tetorit 2009.

55. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse në rastin konkret aplikohet neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, Gjykata do t'iu referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i përket aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe më pas të njëjtat do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.
56. Sipas kritereve të përcaktuar në rastin *Micallef kundër Maltës*, të cilat kritere edhe kjo Gjykatë i pranoi përmes praktikës gjyqësore. Së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë “civile” si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe; së dyti, kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse (shih rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, të cituar më lart, paragrafët 84-85 dhe referencat e cituara në atë rast, shih dhe rastet e Gjykatës [KI122/17](#), parashtrues *Česká Exportní Banka A.S.*, cituar më lart, paragrafët 130 dhe 131; [KI81/19](#), parashtrues *Skender Podrimqaku*, cituar më lart, paragrafët 47 dhe 48; [KI107/19](#), parashtrues *Gafurr Bytyqi*, cituar më lart, paragrafi 53).
57. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata rikujton se rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me vendimin e ZRRE-së, përmes të cilit është revokuar miratimi përfundimtar për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentralet. Duke pasur parasysh këtë, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit në fjalë, me pretendimin se ai cenon të drejtat dhe interesat e tij, se kërcënon stabilitetin e furnizimit me energji dhe se vendime të tilla gjyqësore shkaktojnë dëme të pariparueshme.
58. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës ka iniciuar procedurën në Gjykatën Themelore duke iu referuar nenit 22, paragrafit 2 të LKA-së, me qëllim të shtyrjes së ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së, derisa Gjykata kompetente në procedurë administrative të deklarohet lidhur me atë kërkesëpadi. Ka qenë Gjykata Themelore ajo që ka refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës, duke konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 22.2 të LKA-së, të cilit i referohej parashtruesi i kërkesës. Gjykata rikujton se neni 22.2 i LKA-së parasheh mundësinë e shtyrjes së ekzekutimit të vendimeve deri në marrjen e vendimit meritator për rastin, gjegjësisht deri në marrjen e vendimit gjyqësor.
59. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, siç rezulton nga shkresat e lëndës, kishte “miratimin përfundimtar” për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet, të cilat u anuluan nga ZRRE-ja përmes vendimit [ZRRE: V_1420_2021]. Mund të konsiderohet se vendimi i ZRRE-së për dhënien e autorizimit përfundimtar për ndërtimin dhe zgjerimin e kapaciteteve të reja ka përcaktuar edhe shtyrjen e të drejtave civile të parashtruesit të kërkesës si bartës i atyre autorizimeve, përderisa ai vendim ka qenë i vlefshëm. Rrjedhimisht, revokimi, apo anulimi i miratimit përfundimtar nga ZRRE, ka ndikuar edhe në pamundësinë e ushtrimit të “të drejtave civile” të parashtruesit të kërkesës, të cilat ai i kishte deri në momentin e revokimit të tyre. Për këtë arsye, bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se është plotësuar kriteri i parë për zbatueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ndaj procedurave përkatëse paraprake.
60. Gjykata vëren më tej se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, vendimi për revokimin e autorizimit përfundimtar ishte vendimtar për parashtruesin e kërkesës në procedurën e realizimit të të drejtave të tij civile, dhe kjo e ka penguar drejtpërdrejt atë që të vazhdojë

procesin e realizimit të tyre, dhe me këtë edhe realizimin e planeve të tij për të cilat kishte miratimin e ZRRE-së deri në një moment të caktuar. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se është plotësuar edhe kriteri i dytë për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në procedurat përkatëse paraprake.

61. Për këtë arsye, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, janë plotësuar kriteret për zbatueshmërinë e garancive procedurale të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
62. Tani që Gjykata ka konstatuar se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, ajo rikujton gjithashtu rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

63. Gjykata së pari thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
64. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GJEDNJ-së, [Kemmachev kundër Francës](#) kërkesa nr. [17621/91](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Lituanisë](#), kërkesa nr. [71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#) kërkesa nr. [4241/03](#), kategoria (iii)).
65. Me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
66. Duke iu rikthyer rastit konkret, si dhe pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e bazoi shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje

me nenin 6 të KEDNJ-së në dy pretendime, përkatësisht, i) vërtetim i gabuar i gjendjes faktike dhe zbatim i gabuar i të drejtës, dhe këtë shkelje të pretenduara i shpjegon „si pasojë e mos-zbatimit të obligimeve të tyre ligjore, që, ndërkaq, ka ndikuar që gjykatat të vërtetojnë në mënyrë të gabuar gjendjen faktike dhe të zbatojnë në mënyrë të gabuar të drejtën materiale“, dhe ii) mungesa e arsytimit të vendimeve të gjykatave të rregullta në lidhje me pretendimet e tij, më konkretisht se aktgjykimet e gjykatave nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 160 të Ligjit nr. 03/L-006 LPK.

67. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i shqyrtojë të dyja pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kuptimin thelbësor për të përcaktuar bazueshmërinë e tyre në lidhje me shkeljen e mundshme të të drejtave procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në të cilat ai thirret në kërkesë.

Lidhur me pretendimet për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale

68. Para se të merret me këtë pretendim, Gjykata rikujton se, sipas praktikës së GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, detyrë e këtyre gjykatave nuk është të rishqyrtojnë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih GJEDNJ, *Pronina kundër Rusisë*, vendim për pranueshmëri i 30 qershorit 2005, kërkesa numër [65167/01](#)). Në të vërtetë, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta në vlerësimin e fakteve dhe provave, por, është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i vlerësojnë faktet dhe provat të cilat i kanë administruar (shih Gjykata Evropiane, *Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 10 majit 2005, kërkesa numër [19354/02](#)). Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është që të shqyrtojë nëse, eventualisht, ka ardhur deri te shkelja apo shpërfillja e të drejtave kushtetuese (e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për qasje në gjykatë, e drejta për mjete efektive juridike, etj.), si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë, eventualisht arbitrarisht apo diskriminues.
69. Pikërisht duke i lidhur parimet e lartpërmendura me rastin konkret, Gjykata konstaton se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike qëndron në pretendimin se gjykatat nuk e kanë marrë parasysh faktin se në kërkesën e parashtruar në Gjykatën Themelore i ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara të nenit 22 par. 2 të LKA-së, që në vetvete nënkupton se kërkesa e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së është dashur të aprovohet nga Gjykata Themelore. Vetë fakti që kërkesa e tij u refuzua, sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, çon në përfundimin se ato kushte as nuk janë marrë parasysh nga gjykata.
70. Duke analizuar këtë pretendim në lidhje me aktvendimin e Gjykatës Themelore, Gjykata vëren se nuk është fakt kontestues se me nenin 22 par. 2 të LKA-së, janë përshkruar kushtet në detaje në bazë të të cilave gjykata kompetente aprovon apo refuzon kërkesën, po ashtu për Gjykatën nuk është kontestues fakti se parashtruesi në kërkesën e parashtruar për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së i është referuar kushteve të përmendura të parapara në nenin 22. par. 2 të LKA-së, dhe se ai ka paraqitur prova.
71. Megjithatë, ajo që është e evidente edhe për Gjykatën është se Gjykata Themelore, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës, ka shikuar plotësimin e kushteve të cilave iu është referuar parashtruesi i kërkesës, të cilat janë të përcaktuara me nenin 22 paragrafin 2 të LKA-së, si dhe provat që ka paraqitur në vetë kërkesën për shtyrje të ekzekutimit. Gjykata shpreh qëndrimin e saj bazuar në një pjesë të aktvendimit të Gjykatës Themelore, të cilën do ta citojë në këtë rast „Gjykata duke vlerësuar kërkesën

e paditësit, vëren se i njëjti nuk e ka bërë të besueshëm pretendimin e tij me provat të cilat ia ka bashkangjitur padisë [...]”.

72. Kjo do të thotë se është më se e qartë se Gjykata Themelore ka vlerësuar kushtet si dhe provat që parashtruesi i kërkesës i ka paraqitur në Gjykatë në kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit, por që gjatë vlerësimit të tyre ka konstatuar se kërkesa “*nuk e ka bërë të besueshëm pretendimin e tij*” se: a) me ekzekutimin e vendimit të kontestuar do t'i shkactohej dëm, i cili do të ishte i vështirë për t'u riparuar, b) që shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe, c) që shtyrja nuk do t'i shkaktonte dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht palës së interesuar. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos vërejë një konstatim dhe vlerësim tjetër të Gjykatës Themelore, përkatësisht, se kushtet e përcaktuara në nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së janë të natyrës kumulative dhe se si të tilla, duhet të përmbushen në tërësi. Kjo do të thotë se, sipas konstatimeve të Gjykatës Themelore, kushtet që parashtruesi i kërkesës para kësaj gjykate pretendon se janë plotësuar nuk e kanë përmbushur natyrën e tyre kumulative siç parashihet me nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së.
73. Gjykata dëshiron të shtojë këtu se nuk do të lëshohet në një rivlerësim të përmbushjes së kërkesave të nenit 22 paragrafi 2, të LKA-së, që parashtruesi i kërkesës e ka deklaruar në kërkesën pranë Gjykatës Themelore, prandaj edhe nuk do të shprehë mendimin e saj në lidhje me cilësinë e konkluzioneve të Gjykatës Themelore lidhur me mospërmbushjen e tyre, për arsye se “*detyra e gjykatave të rregullta është të vlerësojnë faktet dhe provat që kanë paraqitur*” (shih rastin e cituar të GJEDNJ-së, *Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar*), gjë që Gjykata e ka deklaruar në pjesën përkatëse të aktvendimit.
74. Më tej, në kërkesë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e sjellë një pjesë të pretendimeve për shkëlqjen e nenit 31 të Kushtetutës përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe konstatimin e gjendjes faktike në lidhje me procedurën në Gjykatën e Apelit, duke konsideruar se, duke marrë parasysh „*se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë kushtet e parapara të nenit 22 të Lka-së në lidhje me kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së.*“
75. Në mbështetje të kësaj, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit sapo ka trajtuar këtë pretendim ankimor të parashtruesit të kërkesës, duke gjetur, ndër të tjera, se këto pretendime janë të pabazuara dhe për rrjedhojë të pathemelta. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit i ka paraqitur konkluzionet e saj vetëm pasi ka shqyrtuar thelbin e pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës si pjesë e vendimit të kontestuar të Gjykatës Themelore, duke konsideruar se, *në mënyrë që të aprovohet një kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet/kriteret e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së*“.
76. Gjykata vëren veçanërisht një pjesë të shpjegimit në aktvendimin e Gjykatës së Apelit, ku konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e pabazuar dhe për arsye se mbështetet plotësisht nga faktet që lidhen me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendos në mënyrë meritore pas paraqitjes së provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar dhe se si të tilla, argumentet dhe provat në këtë procedurë nuk mund të ndikojnë në vendimin lidhur me kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së.
77. Një konkluzion i tillë i Gjykatës së Apelit, sipas mendimit të kësaj gjykate, nuk lë vend për pretendimet e parashtruesit të kërkesës se edhe në procedurën pranë Gjykatës së Apelit

ka ardhur deri te zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, përkatësisht nenit 22.2 të LKA-së, sepse vetë fakti që Gjykata e Apelit ka arritur në përfundimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, është e bazuar në fakte dhe prova që nuk janë relevante për këtë pjesë të procedurës, por për procedurën lidhur me padinë administrative, çon në përfundimin se Gjykata e Apelit i ka parë dhe vlerësuar ato në kuptimin thelbësor.

78. Gjykata konstaton më tej se parashtruesi i kërkesës ngre në Gjykatë edhe çështjen e shkeljes së të drejtave materiale nga Gjykata Supreme, në një mënyrë që, përkundër pretendimeve të tij ankimore në revizion, në të cilin ai pretendonte *“se vendimet e shkallëve më të ulëta janë në kundërshtim me Kodin Civil, Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, në aktgjykim konkludoi *“se vendimet janë të qëndrueshme dhe të bazuara ligjërisht, sepse paditësi nuk e ka vërtetuar me fakte dhe prova bindëse për gjykatën... se janë plotësuar kushtet nga neni 22, par. 2 dhe 6 të LKA-së”*.
79. Në kontekstin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljet e bëra nga Gjykata Supreme, Gjykata thekson si në vijim, Gjykata është e mendimit se Gjykata Supreme, në kuptimin thelbësor, i është përgjigjur plotësisht ankesës së parashtruesit të kërkesës në lidhje me përmbushjen e kushteve të nenit 22.2 të LKA-së. Në mbështetje të kësaj, Gjykata Supreme shqyrtoi për herë të tretë përmbushjen e kërkesave të nenit 22.2 të LKA-së, ku arriti në të njëjtin përfundim që është në përputhje me konkluzionet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.
80. Gjykata si bazë për këtë përfundim të saj, e gjen edhe në pjesën e aktgjykimit të Gjykatës Supreme në të cilin fjalë për fjalë thotë: *“Sipas vlerësimit të kolegjit...”*, që në vetvete do të thotë se kolegji i Gjykatës Supreme vlerësoi bazueshmërinë e kushteve të përcaktuara në nenin 22, paragrafi 2 LKA-së, në bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së, por që, sipas mendimit të Gjykatës Supreme, ato jo vetëm që nuk janë përmbushur në kuptimin esencial, por edhe në kuptimin kumulativ, që është një nga kriteret bazë të nenit të përmendur.
81. Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, Gjykata është e mendimit se në procedurën lidhur me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit [ZRRE: V_1420_2021], nuk ka ardhur deri te zbatimii gabuar i së drejtës materiale nga gjykatat e rregullta, dhe prandaj nuk ka pasur shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ndërsa për vlerësimin e cilësisë së konkluzioneve të gjykatave të rregullta lidhur me vlerësimin e kushteve të përmendura, Gjykata nuk është marrë nga arsyet e përmendura tashmë në pjesën e mëparshme të aktvendimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me mungesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore

82. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së e sjellë në lidhje me faktin se gjykatat e rregullta morën vendime që nuk ishin në përputhje të plotë me detyrimet ligjore të nenit 160, paragrafi 4 të LKP-së, se gjykatat i kanë interpretuar në mënyrë shumë të ngushtë kushtet e parashikuara me nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së dhe se nuk i kanë arsyetuar në mënyrë të vlefshme në përputhje me pretendimet dhe provat e tij.
83. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se dispozita përkatëse e nenit 160, paragrafi 4 i LKP-së, në pjesën përkatëse thekson:

“Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”.

84. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vëren se neni 160, paragrafi 4 i LKP-së rregullon thelbin dhe përmbajtjen e aktgjykimit gjyqësor, përkatësisht se çfarë duhet të ketë një aktgjykim gjyqësor për sa i përket përmbajtjes së tij, si dhe parimeve. që gjykatat duhet t'i përmbahen në këtë drejtim. Bazuar në këtë, mund të konstatohet se parashtruesi i kërkesës e sjellë shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me faktin se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë të arsyetuara në pajtim me detyrimin ligjor të nenit 160, paragrafi 4 i LKP-së, për arsyen “se gjykatat i kanë interpretuar shumë ngushtë kushtet e parapara me nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së, lidhur me miratimin e kërkesës së tij për pezullimin e ekzekutimit të vendimit”. Më konkretisht, ato nuk i kanë arsyetuar në mënyrë të detajuar në vendime, gjë që ka çuar drejtpërdrejt në shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
85. Prandaj, duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në kontekstin e vendimeve gjyqësore të paarsyetuara, Gjykata thekson se sipas praktikës së vendosur të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së i detyron gjykatat, ndër të tjera, që të arsyetojnë vendimet e tyre. Megjithatë, ky detyrim nuk mund të kuptohet si detyrim për të paraqitur të gjitha detajet në vendime dhe për të dhënë përgjigje në të gjitha pyetjet dhe argumentet e paraqitura. Shkalla në të cilën ekziston ky detyrim varet nga natyra e vendimit (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Ruiz Torija kundër Spanjës*, kërkesa nr. [18390/91](#) e 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29). GJEDNJ dhe Gjykata Kushtetuese kanë theksuar në vendime të shumta se gjykatat e brendshme kanë një liri të caktuar vlerësimi në lidhje me atë se cilat argumente dhe prova do të pranojnë në një rast të caktuar, por në të njëjtën kohë kanë detyrimin të arsyetojnë vendimin e tyre duke shprehur arsye të qarta dhe të kuptueshme në të cilat e kanë bazuar atë vendim (shih aktgjykimin e GJEDNJ, *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. [37801/97](#) i 1 korrikut 2003).
86. Megjithatë, edhe pse GJEDNJ pohon se neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, obligon gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, ajo gjithashtu ka konsideruar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. (Shih: rastet e GJEDNJ-së, aktgjykimi *Van de Hurk kundër Holandës*, kërkesa nr. [16034/90](#), e 19 prillit 1994, par. 61., aktgjykimi *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, kërkesa nr. [134/1996/753/952](#), e 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).
87. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (Shih: rastet e GJEDNJ-së, dhe atë; aktgjykimin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. [30544/96](#), e 21 janarit 1999, paragrafi 29; aktgjykimin *Hiro Balani kundër Spanjës*, kërkesa nr. [18064/91](#) e 9 dhjetorit 1994).
88. Duke vlerësuar saktësisht rrethanat e rastit si dhe vetë natyrën e procedurës së parashtruesit të kërkesës në lidhje me pretendimin se vendimi i Gjykatës Themelore nuk i plotëson kushtet e vendimit të arsyetuar të përcaktuara me nenin 160 paragrafi 4 i LKP-së, Gjykata konstaton se arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës Themelore është i shkurtër për nga përmbajtja, por nuk është parakusht i mjaftueshëm për të konstatuar se ai është

gjithashtu i pamjaftueshëm në kuptimin thelbësor për arsye se, siç ka deklaruar Gjykata, “është obligim i gjykatës të arsyetojë vendimet e saj, por ajo nuk është e detyruar të japë përgjigje në të gjitha pyetjet e bëra dhe të gjitha argumentet e paraqitura”.

89. Në këtë kontekst, duke shqyrtuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në kuptimin esencial, Gjykata konstaton se Gjykata Themelore në procedurë ekskluzivisht ka vlerësuar përmbyshjen e kushteve të parapara të nenit 22.2 të LKA-së, në kuptimin procedural në pajtim me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, për të cilën ka dhënë arsyetim në vendimin e kontestuar. Gjykata është e mendimit se arsyetimi i dhënë, “se kushtet e parashikuara në nen nuk janë plotësuar në kërkesën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës në gjykatë”, vërteton pa mëdyshje se ato janë marrë në shqyrtim. Për më tepër, në këtë konkluzion, Gjykata vendos në plan të parë natyrën e procedurës, e cila lidhet ekskluzivisht me vlerësimin e plotësimit të kushteve dhe jo me meritat e kërkesëpadisë, që sigurisht kërkon një qasje tjetër procedurale para gjykatës në përputhje me kërkesën e nenit 160 paragrafi 4 i LPK-së.
90. Prandaj, Gjykata është e mendimit se aktvendimi i Gjykatës Themelore nuk është i paarsyetuar në pajtim me nenin 160, paragrafi 4 i LKA-së, siç thekson parashtruesi në kërkesë, për arsye se Gjykata Themelore, në një në mënyrë të drejtë, ka marrë parasysh të gjitha kushtet që parashikon dispozita ligjore e nenit të përmendur, përkatësisht; i) se ka shqyrtuar “kërkesat e palës”, ii) se “ka shqyrtuar nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbyshur kërkesat e nenit 22 par. 2 të LKA-së,” iii) se në aktvendim, pas vlerësimit të kërkesës, ka konstatuar se kërkesat e parapara ligjore duhet të plotësohen në mënyrë kumulative nga paditësi, për të shtyrë më pas ekzekutimin e vendimit të kontestuar.
91. Duke shqyrtuar më tej aktvendimin e Gjykatës së Apelit në kontekstin e një vendimi të paarsyetuar, përkatësisht nenit 160, paragrafi 4 i LPK-së, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka trajtuar çështjen e ngritur nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me vlerësimin e plotësimit të kushteve të nenit 22 paragraf. 2 i LKA-së, duke konstatuar se gjykata nuk do t'i shqyrtojë si të tilla, sepse ato lidhen drejtpërdrejt me thelbin e kërkesëpadisë që është në fazën e shqyrtimit në gjykatë.
92. Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit me të drejtë mbajti një qëndrim të tillë, për arsye se duke u marrë me shqyrtimin, analizën dhe vlerësimin e rrethanave që nuk lidhen drejtpërdrejt me procedurën e pezullimit të ekzekutimit, por me procedurën e vendosjes për ligjshmërinë e vendimit të ZRRE-së, ajo drejtpërdrejt vë në dyshim edhe rezultatin e mundshëm të procedurës administrative.
93. Prandaj, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit ka vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, por nuk ka mundur t'i vlerësojë ato si të tilla, duke pasur parasysh se ato mund të jenë vendimtare në lidhje me procedurën që është në vazhdim e sipër.
94. Më tej, duke vlerësuar procedurën në Gjykatën Supreme në kontekstin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme është marrë me të njëjtat pretendime ankimore në kontekstin e mosplotësimit të kërkesave të nenit 160.4 të LPK-së nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit.
95. Pikërisht në lidhje me këtë, Gjykata tërheq vëmendjen për pjesët e rëndësishme të aktgjykimit të Gjykatës Supreme, të cilat si të tilla tregojnë qartë qasjen e gjykatës në shqyrtimin dhe analizën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës. Në mbështetje të kësaj, Gjykata Supreme, lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për

mospërmbushjen e detyrimeve të nenit 160.4 të LPK-së, nga Gjykata Themelore dhe e Apelit, thotë. *“pretendimet në këtë drejtim se vendimet e atakuara nuk janë të arsyetuar ligjërisht, nuk janë të qëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje, nga ajo e vendosur si në vendimin e gjykatës së shkallës së dytë, i cili është i qartë dhe i arsyetuar mjaftueshëm ligjërisht ashtu si parashihet në nenin 22 të UA-së, lidhur me faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë “*

96. Për më tepër, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme i është përgjigjur në mënyrë konkrete parashtruesit të kërkesës dhe pretendimit lidhur me faktin se me marrjen e një vendimi të tillë në lidhje me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së, ai pëson dëm të pariparueshëm, në mbështetje të kësaj, Gjykata Supreme konkludoi *„[...] si do që të vendoset çështja kryesore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur me vendim përfundimtar gjyqësor, apo nëse do të vërtetohej se vendimi i të paditurit është jo ligjor dhe çështja do të vendosej në dobi të palës paditëse, ekzistojnë mekanizmat dhe mënyra e kompensimit të dëmeve eventuale me mjete monetare, prandaj dëmi do të ishte i sanueshëm “.*
97. Përveç kësaj, Gjykata nuk mund të mos vërë re se Gjykata Supreme gjithashtu u lëshua në vlerësimin e një kushti tjetër të parashikuar me nenin 22.2 të LKA-së, në lidhje me interesin publik, mbi të cilin parashtruesi i kërkesës e bazoi pretendimin e tij në domosdoshmërinë e aprovimit të kërkesës së tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së. Duke analizuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës në kuadër të interesit publik, Gjykata Supreme konstatoi se arsyet e parashtruesit të kërkesës të deklaruara në kërkesë. *„ nuk janë të qëndrueshme, relevante apo me ndikim për tu pranuar në këtë fazë të procedurës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, para se të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me padi, në procedurë të rregullt nga gjykata “.*
98. Në bazë të sa më sipër, Gjykata i cilëson pretendimet e parashtruesit të kërkesës se vendimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme nuk janë në përputhje me nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së, si pretendime që bëjnë pjesë në kategorinë (iii) e pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”.*
99. Në lidhje me këtë, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në kontekstin e vendimeve të paarsyetuara gjyqësore duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që hyjnë në kategorinë; (iii) e pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”.*

Shkeljet e pretenduara të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës

100. Përkitazi me shkeljen e pretenduar të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të vendosur të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) e pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”* kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:

- a) *kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në*

këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim) nr. 4241/03* i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim) nr. 6032/04* i 25 shtatorit 2008);

b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vet Gjykata nuk vendos ndryshe (shih rastin [KI166/20](#), parashtrues Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 42).

101. Në kontekst të rastit konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm përmend shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit], të Kushtetutës, por ai nuk sqaron, përkatësisht nuk shpjegon fare se si janë shkelur këto të drejta në rastin e tij.
102. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), cituar më lart, paragrafi 52).
103. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenit 24 [Barazia para Ligjit], të Kushtetutës kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi dispozitën e KEDNJ-së, pa shpjeguar se si ajo është shkelur.

Referimi i parashtruesit të kërkesës në praktikën e Gjykatës Kushtetuese në raste të ngjashme

104. Në kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata, ndër të tjera, vlerëson se për të shpjeguar bazueshmërinë e pretendimeve të tij, ai iu referua rasteve [KI 145/18](#), dhe [KI 75/21](#), të cilat ishin objekt i vlerësimit kushtetues të Gjykatës. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i solli rastet e përmendura në kontekst të rastit së tij, duke konsideruar se kërkesa e tij e parashtruar përputhet plotësisht me kërkesat e përmendura dhe se Gjykata duhet të ketë të njëjtën qasje.
105. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata e sheh të nevojshme t'i japë parashtruesit të kërkesës një shpjegim edhe për këtë pretendim, duke mos hyrë në thelbin dhe konstatimet që Gjykata tashmë ka deklaruar gjatë vlerësimit të bazueshmërisë së tyre.
106. Së pari, Gjykata vëren se çdo kërkesë e paraqitur në gjykatë ka specifikat e veta në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, të cilat si të tilla ndikojnë në vetë rezultatin e kërkesës. Në mbështetje të kësaj, Gjykata dëshiron të shtojë se referenca e parashtruesit të kërkesës në rastin [KI 145/18](#) është e pabazuar, duke pasur parasysh se në atë kërkesë thelbi i çështjes ishte i një natyre të ndryshme, më konkretisht, Gjykata në rastin [KI 145/18](#) konstatoi se Gjykata e Apelit nuk e adresoi pretendimin thelbësor të parashtruesve

të kërkesës për trajtim jo të barabartë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e që në krahasim me këtë kërkesë, e cila rezultoi në konkluzione të ndryshme. Gjykata posaçërisht pohon se gjatë shqyrtimit të të dyja kërkesave, ka zbatuar të njëjtat parime të GJEDNJ-së dhe kësaj Gjykate, por ka ardhur në përfundime të ndryshme, të cilat janë ndikuar kryesisht nga specifika e kërkesës dhe procedurat që i kanë paraprirë kësaj procedure.

107. Më tej, sa i përket referencës së parashtruesit të kërkesës në rastin **KI 75/21**, Gjykata rikujton se të dyja kërkesat janë konceptualisht të njëjta, por jo në thelb, gjë që kontribuoi në rezultatin e ndryshëm gjatë shqyrtimit të tyre. Në rastin **KI 75/21**, thelbi i çështjes ka qenë licenca, ndërsa në kërkesën konkrete është leja për ndërtimin e objekteve për prodhimin e energjisë elektrike, që sigurisht paraqet dallim të rëndësishëm që në fillim. Përveç kësaj, pretendimet në kërkesën lëndore që Gjykata i shqyrtoi në kuadër të veprimeve procedurale të ndërmarra nga gjykatat e rregullta në vlerësimin e bazueshmërisë së tyre çoi në përfundimin se ato janë të pabazuara, ndërsa në rastin **KI75/21**, kjo sigurisht nuk ka qenë rasti, i cili ka rezultuar në nxjerrjen e aktgjykimit lidhur me këtë kërkesë.
108. Prandaj, vetëm referimi në kërkesa, të cilat Gjykata i ka shqyrtuar në periudhën e mëparshme, dhe të cilat parashtruesi i kërkesës konsideron se korrespondojnë në thelb me kërkesën e tij, nuk janë bazë e mjaftueshme që kjo Gjykatë të nxjerrë një përfundim identik.

Përfundim

109. Prandaj, Gjykata konkludon se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe pretendimet për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, janë pretendime që cilësohen si (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”. Prandaj, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në tërësi si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27.1 të Ligjit, si dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 janar 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. TË KONSTATOJË se ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

